

VENDIM
Nr. 161, datë 12.10.2017

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E LICENCËS
PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të seksionit II, nenit 22 dhe 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përmirësuar apo modifikuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit të licencuarit me ato të parashikuara në ligjin nr. 102/2015, “Për gazin natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti